



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE
ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS

Nr. 9638 prot.

Tiranë, më 27. 11. 2019

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1732, datë 29.10.2014.

SHOQËRISË “STARDUST” SH.P.K
Rruga “Komuna e Parisit”, Pallati Kristi Co, Kati i Parë, Nr.4, Tiranë.

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “Stardust” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1732, datë 29.10.2014, për mineral hekur - nikeli, në objektin “Leshnicë”, Bashkia Kukës.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën nr.6680, datë 07.11.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.9638, datë 08.11.2019, është propozuar revokimi i lejes shfrytëzimit nr.1732, datë 29.10.2014, për mineral hekur - nikeli, në objektin “Leshnicë”, Bashkia Kukës, sepse keni ndërprere punën në objekt për më shumë se një vit dhe nuk keni paguar garancinë financiare të rehabilitimit të mjedisit, duke mos respektuar kërkesat e nenit 31, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve, është i mbështetur në germën “c” e germën “ç” të pikës 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1732, datë 29.10.2014, për mineral hekur - nikeli, në objektin “Leshnicë”, Bashkia Kukës, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të shfrytëzimit **nr.1732, datë 29.10.2014, për mineral hekur - nikeli, në objektin “Leshnicë”, Bashkia Kukës.**

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTJA

